



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

Legjislatura IV

Komisioni për Buxhet dhe Financa

Mbledhja nr. 07/11

Prishtinë, më 6.04.2011, ora 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla C-203

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR BUXHET DHE FINANCA

Në mbledhje morën pjesë: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa dhe Duda Balje.

Gjithashtu të pranishëm ishin edhe: Bedri Hamza - Ministër i Financave, Agim Krasniqi - Drejtor i Buxhetit, Ymer Havolli, Ruzhdi Morina dhe Adrian Zalli nga TKPK, Safet Hoxha nga KRPP, Mursel Rraci nga APP, Ekrem Saliu nga OSHP, Ramadan Islami, Teki Shala dhe Njomza Ilazi nga GIZ si dhe monitorues Zyra e Presidentit, OSCE, KDI dhe USAID.

Nga stafi mbështetës i komisionit: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli dhe Aurora Ademi (praktikante).

Mbledhjen e kryesoi Safete Hadërgjonaj, Kryetare e Komisionit.

Për këtë mbledhje propozohet ky rend dite:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Financave për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me normat e propozuara nga Ministria për vënien e tatimit të akcizës në Lojërat e Fatit,**
I ftuar: Bedri Hamza, Ministër i Financave
- 3. Shqyrtimi i kërkesës së Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale për Uljen e Taksës Menaxhuese,**
I ftuar: Ymer Havolli, Ushtrues Detyre i Kryesuesit të Bordit Udhëheqës të TKPK-së;
- 4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2010;**
I ftuar: Safet Hoxha, Kryetar i KRPP-së;
- 5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2010;**
I ftuar: Mursel Rraci, Drejtor i APP-së;
- 6. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2010;**
I ftuar: Hysni Hoxha, Kryetar i OSHP-së;

7. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit Vlerësues të Kandidatëve për Guvernator të Bankës Qendrore të Kosovës;
8. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për vitin 2011;
9. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës

Kryetarja, propozojë që në të ndryshme të shqyrtohet Korniza Afatmesme e Shpenzimeve e Kuvendit të Kosovës për vitin 2012-2014. Propozimi u përkrah njëzëri.

Rendi i ditës u miratuar me plotësim në pikën në të ndryshme.

2. Shqyrtimi i kërkesës së Ministrisë së Financave për konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, lidhur me normat e propozuara nga Ministria për vënien e tatimit të akcizës në Lojërat e Fatit

Kryetarja, njoftoi anëtarët se me nenin 3.2 të Ligjit nr.03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, është paraparë e drejta e Qeverisë që në konsultim me Komisionin për Buxhet dhe Financa, të mund të shtojë listën e mallrave në Aneksin A të këtij ligji, që do ti nënshtrohen normës së tatimit të Akcizës. Konform kësaj dispozite, Ministria e Financave ka i ka paraqitur Komisionit kërkesë për konsultim për propozimin e saj për shtimin e disa mallrave në lojërat e fatit, që do t'iu nënshtroheshin normës së akcizës, kur dihet se me Ligjin për TVSH-në, lojërat e fatit nuk kanë paguar tatim, përveç taksës së licencimit.

Bedri Hamza, pasi që me Ligjin e TVSH-së, lojërat e fatit nuk tatimohen, si rezultat i konsultimeve me ekspert vendor dhe ndërkombëtar, konsultimit me Odën Ekonomike të Kosovës, Aleancën Kosovare të Biznesit dhe Odën Amerikane të Kosovës, të cilat kanë dhënë përkrahjen në propozimet tona dhe pas analizës së vendeve që aplikojnë norma të tilla të akcizës në lojërat e fatit, siq është Anglia, kemi kërkuar nga ky Komision që të konsultohemi me propozimin tonë, në mënyrë që ti propozojmë Qeverisë, që konform ligjit, të shtohet lista e mallrave dhe caktimi i normave të tatimit të akcizës në Lojërat e Fatit, të cilat iu janë prezantuar edhe me shkrim.

Naser Osmani, theksoi problemi i veprimit të lojërave të afatit do të duhej të zgjidhej me ligj dhe ishte dashur të mendohej për një model të rregullimit të tyre, pasi që shumë vende e kanë të rregulluar këtë veprimtari me ligj. Përkrahu propozimet për caktimin e akcizës në lojërat e caktuara të fatit, ndërsa kërkojë sqarime për shumat e cekura, a është fjala për një muaj kalendarik, do të ishte mirë të ishin më të precizuara.

Bedri Hamza, në kërkesën e ngritur për procedimin e ligjit për lojërat e fatit, theksoi se ai është pjesë e strategjisë legjislative dhe do të procedohet në Kuvend. Sa i përket normave të propozuara të akcizave për lojërat e fatit, janë konsultuar praktikantët më të mira, dhe pjesa më e madhe e shumave të propozuara kanë të bëjnë me njësi.

Hykmete Bajrami, përkrahu propozimin e Ministrisë së Financave për caktimin e normës së akcizës në lojërat e fatit, e cila është në funksion në eliminimit të efekteve negative sociale në shoqëri.

Kryetarja, pasi që është në interes të vendit që lojërat e fatit të futen në sistem dhe në bazë të ligjit, propozojë që si Komisioni të japim pëlqimin Qeverisë, për caktimin e normave të akcizës për lojërat e fatit, të propozuara nga Ministria.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

P e r f u n d i m

1. Komisioni për Buxhet dhe Financa, përkrah propozimin e Ministrisë së Financave për shtimin e listës së mallrave dhe caktimin e normave të tatimit të akcizës në Lojërat e Fatit, në Aneksin A të Ligjit nr.03/L-220 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr.03/L-112 për tatimin e normës së akcizës në Kosovë, si në vijim:

- Kazinotë - 5,000.00€, për çdo muaj kalendarik,
- Lojërat elektronike dhe slot-makinat të tjera të vendosura në mjediset e kazinosë- 500.00 €, për çdo muaj kalendarik, për çdo kompjuter, makinë elektronike apo slot-makinë.
- Makinat elektronike më shumë se një pozicion - 500.00€, për do muaj kalendarik, për çdo pozicion,
- Bastet Sportive - për subjektet që organizojnë baste sportive - 600.00€, për do muaj kalendarik, për çdo pikë të shitjes së biletave (basteve sportive),
- Operatorët e lojërave në automate – 500.00, për çdo muaj kalendarik,
- Ruletë për makinat elektronike më shumë se një pozicion – 300.00, për çdo muaj kalendarik,
- Tombolat bingo në lokalet e mbyllura- 100.00€, për çdo muaj kalendarik dhe
- Lotaria e Kosovës – 16% të vlerës së tiketave të shitura, për çdo muaj kalendarik.

3. Shqyrtimi i kërkesës së Bordit të Trustit të Kursimeve Pensionale për Uljen e Taksës Menaxhuese

Kryetarja, shkurtimisht njoftoi me bazën ligjore, në bazë të së cilës është Bordi i Trustit ka propozuar uljen e taksës menaxhuese nga 0.80% sa ka qenë, në 0.65%, duke filluar prej 1 janarit të viti 2011. Bashkangjitur me këtë material e kemi edhe buxhetin e trustit për vitin 2011, të aprovuar nga Bordi, me sqarime të kufizuara për shpenzimet e planifikuara, dhe në mungesë të raportit për vitin 2010 është vështirë të bëhen analiza të detalizuara.

Ymer Havolli, theksoi se kërkesa për uljen e taksës është rezultat i rritjes së kontribuesve pensional, por edhe rritjes së shpenzimeve menaxhuese të mjeteve të trustit. Përmes kësaj takse financohen edhe shpenzimet operative të trustit, ku një pjesë e tyre do të mbulohen nga suficiti i viteve paraprake.

Kryetarja, pasi që shifet se trusti ka parashikuar që në buxhetin e vitit 2011 të ketë deficit, i cili do të mbulohet nga suficiti i viteve të kaluara, theksoi se deri më tani nuk kemi marrë ndonjë informacion me shkrim për suficitin e viteve paraprake dhe menaxhimin e tij, ashtu siq nuk kemi pasur të dhëna të detalizuara për shpenzimet e trustit, prandaj është e nevojshme një sqarim në këtë drejtim.

Naser Osmani theksoi se kërkesa për uljen e taksës është si rezultat i rritjes së masës së parasë, për shkak të rritjes së kontribuesve pensional. Buxheti i Trustit, nuk ofron sqarime të mjaftueshme që arsyetojnë kërkesën e trustit dhe kemi nevojë për detalizimin e shpenzimeve që të kemi më lehtë, të përkrahim kërkesën për uljen e taksës menaxhuese.

Xhevdet Neziraj, gjithashtu evidentoi mungesën e detalizimit të shpenzimeve, ndërsa sa i përket kërkesës për uljen e taksës menaxhuese, shifet se është bërë për shkak të rritjes së kontribuesve. Ndërsa sa i përket investimit të mjeteve prej 7.5 %, në bankat që operojnë në Kosovë, këto mjete janë

investuar në bankat me kapital të huaj, dhe kjo nënkupton se kemi kontribut të vogël në rritjen e zhvillimit ekonomik nga këto mjete.

Sali Asllanaj, theksoi se jemi për të përkrahur kërkesën për ulje të taksës menaxhuese, por megjithatë do të ishte mirë të kemi një raport më të detalizuar të shpenzimeve, si dhe të tregoheshin përvojat e investimit të mjeteve në Kosovës dhe diferenca e investimit të tyre në kompanitë menaxhues. Një çështje tjetër është mungesa e transparencës, në ofrimin e informacioneve për kontribuesit.

Ymer Havolli, njoftoi se shpenzimet menaxhuese, janë taksat që iu paguhen aset menaxherëve, për investimin e mjeteve të trustit në tregun financiar pajtime me strategjinë në të cilën bordi e ka aprovuar në mënyrë që të rriten përfitimet sa është e mundur, që janë mjete të pakthyera. Sa i përket investimeve jashtë vendit, përkundër krizës në Japoni, ne kemi vepruar normalisht. Pamundësia e investimit më të madhë të mjeteve në Kosovë, për shkak të kufizimeve ligjore. Shpërndarja e informacioneve për gjendjen e llogarive të kontribuesve, bëhet përmes postës, në bazë të kontratës që kemi lidhur.

Muhamet Mustafa, theksoi se më të drejtë po kërkohet një bilanc më detal i shërbimeve profesionale të Trustit, për koston e shpenzimeve administrative dhe menaxhuese. Vlerësoi se rritja e investimi i mjeteve në aset menaxherët, duhet të ndërlidhet në bazë të performancës së tyre. Në përgjithësi buxheti i Trustit është 42% më i lartë se vitin e kaluar, edhe pse ulet taksa.

Adrian Zalli, njoftoi se janë mbi 350.000 kontribues, dhe në çdo kohë në web faqen e trustit, mund të shihet performanca dhe gjendja e kontributeve. Si rezultat i rritjes së aseteve rriten edhe shpenzimet për menaxhimin e tyre. Sa i përket menaxherëve të mëdhenj, ata i kanë taksat fikse dhe nuk mund të ndikojmë për ato, ndërkaj për aset menaxherët e vegjël, mund të diskutohet për performancën e tyre, të cilët marrin taksë fikse dhe taksë për performancën e tyre.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë propozimin e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës për uljen e taksës menaxhuese nga 0.80% në 0.65%, dhe e njëjta të jetë e zbatuar nga 1 Janari i vitit 2011.

4. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik për vitin 2010 dhe i Raportit vjetor të Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2010

Kryetarja, tregoi për bazën ligjore, në bazë të së cilës KRPP-ja i raporton Kuvendit një herë në vit, për aktivitetet e prokurimit publik dhe raporti si i tillë përfshin të gjitha kushtet që parashihen me ligj. Në bazë të ligjit parashihet që KRPP-ja dhe APP-ja, të përgatisin një raport të përbashkët për Kuvendin, ndërkaj këto dy agjencioni i kanë sjellur raportet e ndara, për këtë kërkoi një sqarim nga përfaqësuesit e ftuar?

Safet Hoxha, shkurtimisht prezantoi raportin vjetor, i cili përmbledh aktivitetet e prokurimit publik të ndodhura gjatë vitit 2010, të cilat janë përfshirë ashtu siq i kanë dorëzuar autoritetet kontraktuese njoftimet në formë elektronike. Gjithashtu raporti përmban edhe informacione për monitorimet që i ka bërë KRPP-ja (të cilat nuk janë realizuar siq kemi planifikuar për shkak të ikjes së punëtorëve dhe

transferimit të detyrës së bordit), trajnimet në bashkëpunim me IKAP-in dhe rekomandimet për nevojën e përmisimit të sistemit të prokurimit publik, siq i parasheh ligji.

Hykmete Bajrami, theksoi se problemet e procedurave të prokurimit janë evidente. Sa i përket monitorimeve, vlerësoi se janë bërë shumë pak, zyrtarët që kanë lëshuar punën është dashur të zëvendësohen me të rinj. Ndërsa pyeti qfarë do të bëhet me tri komuna nuk i kanë dorëzuar raportet në formë elektronike? Rekomandimet duhet të ishin më të specifikuara, që të dihen pengesat ligjore që po ndikojnë në ngecjet e procedurave në prokurimin publik. Sa i përket procedurave të hapura nuk duhet të krahasohemi me vendet e rajonit, kur dihet se Kosova është ndër dhjetë vendet më të korruptuara.

Sali Asllanaj, vlerësoi raportin të përmbledhur dhe rekomandimet që janë bërë do të duhej të merreshin parasysh në ndryshimin e ardhshëm të ligjit.

Muhamet Mustafa, problemet e prokurimit janë përmendur edhe në raportin e progresit dhe kjo paraqet një qeshtje serioze, sidomos kontratat njëburimore, që do të duhej të zvogëloheshin, e që në fakt ky sugjerim është dashur të jetë pjesë e rekomandimeve të KRPP-së.

Xhevdet Neziraj, theksoi se nga raporti shifet se ka pak përmisime në sistemin e prokurimit publik. I kemi të njëjtat vërejtje dhe rekomandime si në vitet paraprake, e që në fakt është dashur që të kemi përmisime në prokurimin publik këtë vit nga vërejtjet dhe rekomandimet e bëra viteve të kaluara.

Hasime Krasniqi, vlerësoi raportin të detajuar, me të dhëna krahasuese me vitin paraprak, nga i cili shifet përmisimi i aktiviteteve të prokurimit këtë vit. Rritja e prokurimeve përmes procedurave të hapura është për tu vlerësuar, ndërkaq u pajtua me kërkesën e z. Mustafa për zvogëlimin e kontratave një burimore, ndërsa si vërejte tjetër përmendi kontratat që negociohen para publikimit.

Latif Gashi, sa i përket mosraportimit të tri komunave, pyeti a i raportojnë ndonjë institucioni tjetër, dhe në këtë drejtim a keni bashkëpunim me ICO, se a iu raportojnë këto komuna atyre. Kjo është në interes të dihet, pasi që këtë komuna shfrytëzojnë buxhetin e Kosovës?

Safet Hoxha, në përgjigjen e pyetjeve, theksoi se kemi përmisime të aktiviteteve të prokurimit publik, krahasuar me vitin e kaluar, siq është rasti i procedurave të negociuara të hapura. Sa i përket mosdorëzimit të raporteve nga tri komunat, kemi bërë përpjekje që ti marrim raportet por nuk kemi arritur, dhe nuk kemi të dhëna se i raportojnë ndonjë institucioni tjetër. Vështërsitë në zëvendësimin e punëtorëve, për shkak se kërkohen zyrtarë të certifikuar. Kemi ndryshuar monitorimin, sidomos kriteret diskriminuese të tenderimit, e që si rezultat kemi anuluar disa publikime të autoriteteve kontraktuese.

Kryetarja, propozoi që në rekomandimin e Komisionit për Kuvendit, raporti i APP-së të jetë aneks, i raportit të KRPP-së. Propozimi u përkrah njëzëri.

Kryetarja, konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit të miratojë Raportin vjetor për vitin 2010 të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik dhe raportin e Agjencisë së Prokurimit Publik për vitin 2010, si aneks të raportit të KRPP-së.

5. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Organit Shqyrtues të Prokurimit për vitin 2010

Kryetarja, prezantoi bazën ligjore për raportim të OSHP-së dhe kushtet ligjore që duhet ti përmbaj raporti. Raporti si tillë përmban të gjitha kriteret që i parasheh ligji.

Ekrem Salihu, prezantoi aktivitetet e OSHP-së në procesin e shqyrtimit të ankesave, vendimet për këto ankesave dhe krahasimin me vitin paraprak, që vërehet rritje e ankesave dhe besueshmërisë në OSHP. Për tenderët njëburimor APP-ja i është përgjegjëse për aprovimin e tyre, ndërkaq OSHP-ja për shqyrtimin e ankesave. Për ankesat e parashtuara janë të parapara kriteret për trajtimin e tyre.

Xhevdet Neziraj, nga raporti shifet se kemi rritje të ankesave, në krahasim me vitin e kaluar, gjë që e demanton raportimin e përfaqësuesit të KRPP-së, dhe është mirë që operatorët ekonomik po ankohen.

Hykmete Bajrami, dihet fakti se ankesa e shtyhet procedurën e dhënies së kontratës, në këtë drejtim pyeti a ka kriteret për tu marrë për bazë një ankesë. Sa i përket tenderëve njëburimor, pyeti a keni ankesa për këtë qëllim dhe sa është pjesëmarrja në tenderët njëburimor?

Muhamet Mustafa, theksoi se numri i ankesave nuk është i madh, por problem qëndron të besueshmëria dhe procedurat, kundër vendimeve të OSHP-së dhe Gjykata Supreme, për çështjen e kompenzimeve të dëmeve, ndaj operatorëve ekonomik.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

1. I rekomandohet Kuvendit miratojë Raportin vjetor për vitin 2010 të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

6. Shqyrtimi i Propozimit të Panelit të Bordit të Bankës Qendrore të kandidatëve për Guvernator të Bankës Qendrore të Kosovës

Kryetarja, propozojë që kjo pikë të shtyhet për një mbledhje tjetër të komisionit, pasi që nga protokollimi i shkresës, shifet se nuk ka kaluar afati ligjor prej pesëmbëdhjetë ditësh, ku Qeveria, mund të jap një mendim Kuvendit, për propozimin e Panelit.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

P ë r f u n d i m

Propozimi i Panelit të Bordit të Bankës Qendrore të kandidatëve për Guvernator të Bankës Qendrore të Kosovës, shtyhet për shqyrtim në një mbledhje tjetër të Komisionit.

7. Shqyrtimi i draft-planit të punës së Komisionit për vitin 2011

Kryetarja, njoftoi me përgatitjen e draft-planit vjetor të Komisionit, i cili mund të plotësohet dhe ndryshohet me propozime konkrete, deri në mbledhjen e radhës.

8. Të ndryshme:

8.1. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012-2014

Ismet Krasniqi, shkurtimisht prezantoi projektet dhe shpenzimet të planifikuara nga Kuvendit, për periudhën 2012-2014, të cilat ishin të prezantuara edhe me shkrim. Ndër problemet është mos shpenzimi i mjeteve për Vila Gërmija, që po ka efekt edhe në projektet tjera kapitale.

Sali Asllanaj, pyeti qfarë është qëndrimi për projektin kapital – Vila Gërmija? Është një projekt që iu duhet Kuvendit dhe të kryhet një herë e përgjithmonë, dhe është në interes të vendit.

Ismet Krasniqi, shpjegoi historikun e rrjedhës së punëve të projektit Vila Gërmija, për të cilën seanca plenare më 17.07.2006, ka vendosur që të vazhdohen punimet, por që puna nuk është përfunduar. Kërkoi nga Komisioni që të kërkojë nga Kryesia apo Kuvendi që të diskutojë vendimin e marrur për këtë projekt.

Naser Osmani, vlerësoi të rëndësishme ekzistimin e një qendre protokolare. Do të duhej që ky komision, të dal me rekomandim për Kryesinë dhe gjithë deputetët duke e thirrur në vendimin e Kuvendit të vitit 2006, dhe ne ti parashikojmë mjetet që për tri vite, që projekti të përfundojë, dhe më pas Kuvendi, të vendos për shitjen apo mosshitjen e tij.

Ismet Krasniqi, njoftoi se është menduar për një zgjidhje, që projekti të realizohet me participimin e tri institucioneve (Kuvendit, Zyrës së Presidentit dhe Kryeministrit), dhe do të shfrytëzohet dhe mirëmbahet për nevojat e tri institucioneve. Sa i përket bazës ligjore duhet një vendimmarrje, ndërsa punët teknike të ekzekutimit të projektit, mund të rregullohen.

Muhamet Mustafa, përkrahu mendimin e sekretarit, për realizimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të këtij projekti nga tri institucionet e lartpërmendura.

Latif Gashi, pyeti a ka pengesa ligjore për vazhdimin e investimeve në atë projekt? Ndërkaq mbështeti idenë për investimin dhe shfrytëzimin e përbashkët të projektit nga tri institucionet e lartpërmendura, për projektin Vila Gërmija.

Kryetarja konstatoi se Komisioni, njëzëri, nxori këtë:

R e k o m a n d i m

- I. I rekomandon Kryesisë së Kuvendit, që të miratojë Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve të Kuvendit të Kosovës për vitin 2012-2014.
- II. Për projektin kapital “*Villa Gërmija*”, Komisioni do të dal me rekomandime konkrete.

Mbledhja përfundoi në orën 14:10

Përgatitur nga:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Kryetarja e Komisionit

Safete HADËRGJONAJ



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

IV. Legislatura

Komisija za budžet i finansije

Sednica br. 07/11

Priština, 6.04.2011, od 11:00 časova

Zgrada Skupštine, sala C-203

Z A P I S N I K
SA SEDNICE KOMISIJE ZA BUDŽET I FINANSIJE

Sednici su prisustvovali: Safete Hadërgjonaj, Naser Osmani, Jelena Bontić, Latif Gashi, Hasime Krasniqi, Hykmete Bajrami, Sali Asllanaj, Albana Fetoshi, Xhevdet Neziraj, Muhamet Mustafa i Duda Balje.

Sednici su, takođe, prisustvovali i Bedri Hamza – Ministar za finansije, Agim Krasniqi – Direktor budžeta, Ymer Havolli, Ruzhdi Morina i Adrian Zalli, iz TKPK, Safet Hoxha iz RKJN, Mursel Rraci iz AJN, Ekrem Saliu iz ORN, Ramadan Islami, Teki Shala i Njomza Ilazi iz GIZ, kao i posmatrači iz kancelarije Predsednika, OSBE, KDI i USAID.

Iz podržnog osoblja Komisije: Vilson Ukaj, Sabrije Saliuki – Iseini, Dashurije Canolli i Aurora Ademi (pripravnik).

Sednici je predsedavala Safete Hadërgjonaj, predsednica Komisije.

Za ovu sednicu predložen je sledeći dnevni red:

- 1. Usvajanje dnevnog reda;**
- 2. Razmatranje zahteva Ministarstva za finansije o konsultaciji sa Komisijom za budžet i finansije, u vezi sa predloženim normama od Ministarstva za uvođenje oporezivanja akcize igara na sreću,**
Pozvani: Bedri Hamza – Ministar za finansije

3. Razmatranje zahteva Borda Trusta penzijskih štednji o snižavanju menadžerske takse, Pozvani: Ymer Havolli, vršilac dužnosti predsedavajućeg Upravnog borda TKPK
4. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulatorne komisije za javnu nabavku, za 2010. godinu; Pozvani: Safet Hoxha, predsednik RKJN
5. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Agencije za javnu nabavku za 2010. godinu; Pozvani: Mursel Rraci, direktor AJN
6. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Organa za razmatranje nabavki za 2010. godinu; Pozvani: Hysni Hoxha, predsednik ORN
7. Razmatranje Predloga panela za vrednovanje kandidata za Guvernera Centralne banke Kosova;
8. Razmatranje Nacrta-Plana rada Komisije za 2011. godinu;
9. R a z n o.

1. Usvajanje dnevnog reda

Predsednica je predložila da se pod tačkom razno razmatra Srednjoročni okvir troškova Skupštine Kosova za 2012 – 2014. godinu. Predlog je jednoglasno usvojen.

Dnevni red je usvojen uz dopunu kod tačke pod raznom.

2. Razmatranje zahteva Ministarstva za finansije o konsultaciji sa Komisijom za budžet i finansije, u vezi sa predloženim normama od Ministarstva za uvođenje oporezivanja akcize igara na sreću

Predsednica je upoznala članove da je članom 3.2. Zakona br. 03/L-220 o izmeni i dopuni zakona br. 03/L-112 o oporezivanju norme akcize na Kosovu, predviđeno pravo Vlade da, u konsultaciji sa Komisijom za budžet i finansije, može povećati listu roba u Aneksu A ovog zakona, koji će se podvrgavati normi oporezivanja akcije. Shodno ovoj odredbi, Ministarstvo za finansije je podnelo zahtev Komisiji za konsultaciju o njegovom predlogu za dodavanje nekoliko roba kod igara na sreću, koje će biti podvrgnute normi akcize, imajući u vidu da Zakonom o PDV-u, igre na sreću nisu plaćale porez, osim takse za licenciranje.

Bedri Hamza je rekao da, pošto se Zakonom o PDV-u igre na sreću ne oporezuju, kao rezultat konsultacija sa domaćim i međunarodnim ekspertima, konsultacije sa Privrednom komorom Kosova, Kosovskom alijansom za biznis i Američkom komorom Kosova, koji su dali podršku našim predlozima i nakon analize zemalja koje primenjuju takve norme akcije kod igara na sreću, kao što je Engleska, tražili smo od Komisije da se konsultujemo u vezi sa našim predlogom, kako bi smo predložili Vladi da se, u skladu sa zakonom, povećava lista roba i određivanje normi poreza akcize igara na sreću, koji su prezentirani i u pismenoj formi.

Naser Osmani je naglasio da problem delovanja igara na sreću bi trebalo rešiti zakonom i trebalo bi da se razmišlja o jednom modelu njihovog uređivanja, budući da su mnoge zemlje ovu delatnost regulisale zakonom. Podržavao je predloge za određivanje akcize kod određenih igara na sreću, a tražio je objašnjenja o navedenim iznosima, dali se radi o jednom kalendarskom mesecu, dakle, bilo bi dobro da se sve bolje pojasni.

Bedri Hamza je kod pokrenutog zahteva za procesiranje Zakona igara na sreću, naglasio da je isti deo legislativne strategije i da će procesirati u Skupštini. Kada je reč o predloženim normama akciza igara na sreću, konsultovane su najbolje prakse i najveći deo predloženih iznosa odnose se na jedinice.

Hykmete Bajrami je podržala predlog Ministarstva za finansije za određivanje norme akcije kod igara na sreću, koja je u funkciji eliminisanja negativnih socijalnih efekata u društvu.

Predsednica je naglasila da, budući da je u interesu zemlje da se igre na sreću uvedu u sistem i na osnovu zakona, predlažem da kao komisija damo saglasnost Vladi za određivanje normi akciza za igre na sreću, predloženih od strane Ministarstva.

Predsednica je konstatovala Komisija, jednoglasno, donela sledeći:

Z a k l j u č a k

1. Komisija za budžet i finansije podržava predlog Ministarstva za finansije za povećanje liste roba i određivanje normi poreza akcize Igara na sreću, kod Aneksa A Zakona br. 03/L-220 o izmeni i dopuni Zakona br. 03/L-112 o porezu normi akcija za Kosovo, i to:
 - Kazino – 5,000.00 €, za svaki kalendarski mesec,
 - Elektronske igre i druge slot-mašine smeštene u prostorijama kasina – 500.00 €, za svaki kalendarski mesec, za svaki kompjuter, elektronsku mašinu ili slot-mašinu,
 - Elektronske mašine sa više od jedne pozicije 500.00 €, za svaki kalendarski mesec, za svaku poziciju,
 - Sportske kladionice- za subjekte koji organizuju sportske kladionice – 60.00 €, za svaki kalendarski mesec, za svaku prodajnu tačku karata (sportske kladionice),
 - Operatere automatskih igara, 500.00, za svaki kalendarski mesec,
 - Rulet za elektronske mašine sa više od jedne pozicije – 300.00, za svaki kalendarski mesec,
 - Bingo – tombole u zatvorenim prostorijama - 100.00 € za svaki kalendarski mesec, i
 - Lutrija Kosova – 16% vrednosti prodatih tiketa, za svaki kalendarski mesec.

3. Razmatranje zahteva Borda Trusta penzijskih štednji o snižavanju menadžerske takse

Predsednica je ukratko informisala o zakonskoj osnovi, na bazi koje je Bord Trusta predložio smanjivanje menadžerske takse sa 0.80%, koliko je iznosila, na 0.65%, počev od 1. januara 2011. godine. uz ovaj materijal imamo i budžet Trusta za 2011. godinu, usvojenog od strane Borda, sa ograničenim objašnjenjima o planiranim troškovima i u nedostatku Izveštaja za 2010. godinu, teško je vršiti detaljne analize.

Ymer Havolli je naglasio da je zahtev za smanjivanje takse rezultat povećanja broja platiše penzijskog doprinosa, ali povećanja menadžerskih troškova sredstava Trusta. Preko ove takse finansiraju se i operativni troškovi Trusta, gde će se jedan deo istih pokrivati iz suficita iz prethodnih godina.

Predsednica je rekla da, budući da se vidi da je Trust predvideo da u budžetu 2011. godine bude deficita, koji će se pokrivati iz suficita iz prethodnih godina, do sada nismo dobili neku pismenu informaciju o suficitu iz prethodnih godina i o menadžiranju istog, kao što nismo imali ni detaljne podatke o troškovima Trusta, tako da je u tom smislu potrebno jedno objašnjenje.

Naser Osmani je naglasio da je zahtev za smanjivanje takse rezultat povećanja mase novca, zbog povećanja broja penzijskih platiša doprinosa. Budžet Trusta ne daje dovoljno objašnjenja koja opravdavaju zahtev Trusta i ima potrebe za detaljnim objašnjenjem troškova, kako bi nam bilo lakše da podržavamo zahtev za smanjenje menadžerske takse.

Xhevdet Neziraj je, takođe, evidentirao nedostatak detaljnog prikazivanja troškova, a kada je reč o zahtevu za smanjenje menadžerske takse, očigledno je da je to učinjeno zbog povećanja broja platiša doprinosa. Kada je reč o investiranju sredstava od 7.5% u bankama koja operiraju na Kosovu, ova sredstva su investirana u bankama sa stranim kapitalom, što podrazumeva da imamo manji doprinos na povećanju ekonomskog razvoja kod ovih sredstava.

Sali Asllanaj je naglasio da smo za podršku zahteva za smanjenje menadžerske takse, međutim, ipak bi bilo dobro da imamo jedan detaljan izveštaj troškova, kao i prikazivanje iskustava investicije sredstava na Kosovu i razlike njihovog investiranja u menadžerskim kompanijama. Jedno drugo pitanje se odnosi na nedostatak transparentnosti, pružanju informacija za platiše doprinosa.

Ymer Havolli je informisao da menadžerski troškovi predstavljaju takse koja se isplaćuju aset-menadžerima za investiranje sredstava Trusta na finansijsko tržište, u skladu sa strategijom koju je Bord usvojio, kako bi se povećala dobit koliko god je to moguće, koja su nepovratna sredstva. Kada je reč o investicijama izvan zemlje, i pored krize u Japanu, mi smo normalno poslovali. Nije postojala mogućnost većeg investiranja sredstava na Kosovu, zbog zakonskih ograničenja. Prenosanje informacija o stanju računa platiše doprinosa čini se poštanskim putem, na osnovu ugovora kojeg smo sa njom zaključivali.

Muhamet Mustafa je naglasio da se spravom traži jedan detaljan bilans profesionalnih usluga Trusta, o iznosu administrativnih i menadžerskih troškova. Ocenio je da povećanje i investiranje sredstava u aset-menadžere treba da se međusobno povezuje na osnovu njihove performanse. Budžet Trusta u celini je 42% veći nego u prošloj godini, mada je taksa smanjena.

Adrian Zalli je informisao da je preko 350.000 platiše doprinosa i da se, u svako doba, na Web-stranici Trusta može videti performansa i stanje platiše doprinosa. Kao rezultat povećanja asea – povećavaju se i troškovi za njihovo menadžiranje. Kada je reč o velikim menadžerima, oni imaju fiksne takse i ne mogu na njih uticati, dok kada su u pitanju mali aset – menadžeri, može se diskutovati i o njihovoj performansi, koji dobijaju fiksnu taksu i taksu za njihovu performansu.

Predsednica je konstatovala da je Komisija, jednoglasno, donela sledeću:

P r e p o r u k u

1. Preporučuje se Skupštini da usvaja predlog Trusta penzijski štednji na Kosovu za smanjenje menadžerske takse sa 0.80% na 0.65% i da se ista primenjuje od 1. januara 2011. godine.
4. **Razmatranje Godišnjeg izveštaja Regulatorne komisije za javnu nabavku, za 2010. godinu**

Predsednica je govorila o zakonskom osnovu na bazi čega RKJN izveštava Skupštini jednom godišnje o aktivnostima javne nabavke i da Izveštaj, kao takav obuhvata sve uslove koji se predviđaju zakonom. Na osnovu zakona predviđa se da RKJN i AJN pripremaju zajednički izveštaj za Skupštinu, dok su ove dve agencije, dostavile zasedne izveštaje, o čemu je tražila objašnjenje od strane pozvanog predstavnika.

Safet Hoxha je u kratkim crtama prezentirao godišnji izveštaj, koji sadrži aktivnosti javnih nabavki koje su se dogodile tokom 2010. godine, koje su obuhvaćene onako kako su ogovarački autoriteti dostavili njihove informacije elektronskim putem. Takođe, izveštaj sadrži i informacije o monitorisanjima koje je izvršila RKJN (koje nisu realizovane kako smo planirali zbog odlaska radnika i prenošenja obaveze Borda), obuke u saradnji sa IKAP-om i preporuke o potrebi poboljšanja sistema javne nabavke, kako je zakonom predviđeno.

Hykmete Bajrami je rekla da su problemi procedura nabavki evidentni. Što se monitorisanja tiče, ocenila je da je takvih bilo malo, zvaničnici koji su napustili posao trebalo je da budu zamenjeni novim. S druge strane, upitala je šta će biti sa tri opštine koje nisu dostavile izveštaje elektronskim putem? Preporuke bi trebalo da su specifikovane, kako bi se znale zakonske smetnje koje utiču na zaostajanje procedura u javnoj nabavci. Kada je reč o otvorenim procedurama, ne bi trebalo da se upoređujemo sa zemljama regiona, kada se zna da je Kosovo među deset naj korumpiranih zemalja.

Sali Asllanaj je ocenio izveštaj sažetim i preporuke koje su učinjene – trebalo bi uzeti u obzir kod budućih izmena zakona.

Muhamet Mustafa je rekao da su problemi nabavke navedeni i u Izveštaju u napretku i da ovo predstavlja ozbiljno pitanje, posebno jedno izvorni ugovori, koje bi trebalo smanjiti, a zapravo ova sugestija je trebalo da bude deo preporuka RKJN-a.

Xhevdet Neziraj je naglasio da je očigledno da izveštaj ima malo poboljšanja u sistemu javne nabavke. Imamo iste primedbe i preporuke kao i prethodnim godinama, što je Zapravo, trebalo da imamo poboljšanja u javnoj nabavci u ovoj godini, shodno primedbi i preporuka iz prošlih godina.

Hasime Krasniqi je ocenila da je izveštaj detaljan, koji sadrži komparativne podatke sa prethodnom godinom, iz čega se vidi poboljšanje aktivnosti nabavke u ovoj godini. Povećanje nabavki kroz otvorene procedure valja oceniti, a složila se sa zahtevom g. Mustafa o smanjivanju jedno izvornih ugovora, dok je kao drugu primedbu spomenula ugovore o kojima se pregovara pred objavljivanjem.

Latif Gashi je, kada je reč o ne izveštavanju triju opština, postavio pitanje – da li izveštavaju nekoj drugoj instituciji, odnosno dali u tom pravcu imate saradnju sa ICO-m, dali ove opština njima izveštavaju. To je od interesa da se zna, jer ove opštine koriste budžet Kosova.

Safet Hoxha je, na pitanja poslanika, naglasio da imamo poboljšanja aktivnosti kod javne nabavke, u poređenju sa prethodnom godinom, kao što je slučaj otvorenih procedura pregovaranja. Što se tiče ne dostavljanja izveštaja od strane tri opštine, uložili smo napore da dobijamo izveštaje, međutim nismo uspeli i nemamo podatke da li izveštavaju nekoj drugoj instituciji. Teškoće oko zamenjivanja radnika odnose se na činjenicu da se traže sertifikovani zvaničnici. Menjali smo monitorisanje, posebno diskriminirajuće kriterijume tenderisanja, kao rezultat čega smo poništili nekoliko objavljivanja ugovornih autoriteta.

Predsednica je konstatovala da je Komisija, jednoglasno, donela sledeću:

P r e p o r u k u

1. Preporučuje se Skupštini da usvaja Godišnji izveštaj za 2010. godinu Regulatorne komisije za javnu nabavku i Izveštaj Agencije za javnu nabavku za 2010. godinu, kao aneks – Izveštaja RKJN.

5. Razmatranje Godišnjeg izveštaja Organa za razmatranje nabavki za 2010. godinu

Predsednica je prezentirala zakonski osnov za izveštavanje od strane ORN i zakonske uslove koje treba da sadrži izveštaj. Izveštaj kao takav sadrži sve kriterijume koje predviđa Zakon.

Ekrem Salihu je prezentirao aktivnosti ORN u procesu razmatranja žalbi, odluke na ove žalbe i upoređenje sa prethodnom godinom, gde se primećuje povećanje žalbi i poverenja u ORN. O jedno izvornim tenderima, AJN je odgovorna za njihovo usvajanje, dok ORN za razmatranje žalbi. O podnetim žalbama su predviđeni kriterijumi za njihovo tretiranje.

Xhevdet Neziraj je rekao da se iz izveštaja vidi da imamo povećanje broja žalbi, u odnosu na prošlu godinu, što demantuje izveštavanje predstavnika RKJN i dobro je što se ekonomski operateri žale.

Hykmete Bajrami ističe da je poznata činjenica da žalba odlaže proceduru dodeljivanja ugovora, te je u tom pravcu pitala – da li ima kriterijuma da se žalba uzima u obzir. Što se jedno izvornih tendera tiče, pitala je dali imate u tom smislu žalbi i koliko je učešće kod jedno izvornih tendera?

Muhamet Mustafa je naglasio da broj žalbi nije velik, međutim problem stoji kod poverenja i procedura, protiv odluka ORN i Vrhovnog suda, o pitanju nadoknade štete prema ekonomskim operaterima.

Predsednica je konstatovala da je Komisija, jednoglasno, donela sledeću:

P r e p o r u k u

1. Preporučuje se Skupštini da usvaja Godišnji izveštaj Organa za razmatranje nabavki, za 2010. godinu.

6. Razmatranje Predloga panela Borda Centralne banke za vrednovanje kandidata za Guvernera Centralne banke Kosova

Predsednica je predložila da se ova tačka odloži za jednu od narednih sednica Komisije, budući da se iz protokolisanja dopisa vidi da nije istekao zakonski rok od petnaest dana kada Vlada može da daje mišljenje Skupštini, o predlogu Panela.

Predsednica je konstatovala da je Komisija, jednoglasno, donela sledeći:

Z a k l j u č a k

Predlog Panela Borda Centralne banke o kandidatima za Guvernera Centralne banke Kosova, odlaže se za razmatranje na jednoj od narednih sednica Komisije.

7. Razmatranje Nacrta-Plana rada Komisije za 2011. godinu

Predsednica je informisala o pripremanju Drafta – godišnjeg plana Komisije, koji se može dopuniti i izmeniti konkretnim predlozima, do naredne sednice.

8. R a z n o.

8.1. Razmatranje Srednjoročnog okvira troškova Skupštine Kosova za 2012 – 2014. godinu

Ismet Krasniqi je, u kratkim crtama, prezentirao projekte i planirane troškove od strane Skupštine za period 2012 – 2014, koji su bili prezentirani i u pismenoj formi. Među problemima je ne potrošnja sredstava za Vila – Grmija, što se odražava i kod drugih kapitalnih projekata.

Sali Asllanaj je postavio pitanje – kakav je stav o kapitalnom projektu – Vila – Grmija? To je projekat koji je potreban Skupštini i mora se, jednom za uvek završiti i u interesu je zemlje.

Ismet Krasniqi je govorio o istorijatu toka radova na projektu Vila – Grmija, o kojem je plenarna sednica 17.07.2006. godine odlučila da se radovi nastave, međutim da radovi nisu okončani. Tražio je od Komisije da ona traži od Predsedništva ili Skupštine da diskutuju o donetoj odluci o ovom projektu.

Naser Osmani je ocenio značajnim postojanje jednog protokolarnog centra. Trebalo bi da ova Komisija izlazi sa preporukom za Predsedništvo i za sve poslanike, pozivajući se na odluku Skupštine iz 2006. godine i da mi predviđamo sredstva kojima bi se projekat za tri godine završio, i da nakon toga Skupština odlučuje o prodaji ili ne istog.

Ismet Krasniqi je informisao da se razmišljalo za jedno rešenje, da se projekat realizuje uz participaciju triju institucija (Skupštine, Kancelarije Predsednika i Premijera), te da se koristi i podržava za potrebe triju navedenih institucija. Što se zakonskog osnova tiče, potrebno je donošenje jedne odluke, dok se tehnička pitanja izvršenja projekta mogu regulisati.

Muhamet Mustafa je podržavao mišljenje sekretara za zajedničku realizaciju u korišćenje ovog projekta od strane triju gore navedenih institucija.

Latif Gashi je pitao – da li ima zakonskih smetnji za nastavak investicija na tom projektu? S druge strane, podržavao je ideju za zajedničkom investicijom i korišćenjem projekta od triju gore navedenih institucija, dakle projekta Vila – Grmija.

Predsednica je konstatovala da je Komisija, jednoglasno, donela sledeću:

P r e p o r u k u

- a. Preporučuje se Predsedništvu Skupštine da usvaja Srednjoročni okvir troškova Skupštine Kosova za 2012 – 2014. godinu.

- b. O kapitalnom projektu „Vila – Grmija“, Komisija će izaći sa konkretnim preporukama.

Sednica je zaključena u 14:10 časova.

Pripremljeno od:
Jedinice za podršku Komisije

Predsednica Komisije,

Safete HADËRGJONAJ